



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/26  
Datë: 23.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. Prizren.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
  - 2.1. Ylber Elshani, kryesues dhe drejtor;
  - 2.2. Arieta Vula-Pozhegu, drejtore;
  - 2.3. Altin Sahiti, drejtor, dhe
  - 2.4. Edmond Halimi, drejtor.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**ARSYETIM**

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike  
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija  
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

<b>DATË/E:</b>	21.4.2020
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Qeverinë e Republikës së Kosovës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Rozeta HAJDARI, Ministre në detyrë, MEPTINIS
<b>TEMA/ SUBJEKAT /SUBJECT:</b>	<b>Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkarkimin e bordit të drejtorëve dhe emërimin e bordit të përkohshëm të ndërmarrjes publike qendrore Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren</b>

I nderuar Kryeministër Kurti,  
i nderuar Zëvendëskryeministër Abazi,  
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, i propozoj Qeverisë të shkarkojë bordin e drejtorëve dhe të emërojë një bord të përkohshëm në ndërmarrjen KRU “Hidroregjioni Jugor” të Prizrenit.

Sipas ligjit, Qeveria duhet të shkarkojë drejtorët kur ka “arsye për të besuar” se kanë shkelur detyrat fiduciare.<sup>1</sup>

Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë opinion të kundërt për pasqyrat financiare të ndërmarrjes për vitin 2018. Opinion i kundërt domethënë se pasqyrat financiare “nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë”.<sup>2</sup> Përgjegjësia për pasqyrat bie mbi Bordin, dhe veçanërisht kryesuesin.<sup>3</sup> Për më tepër, Bordi ka lejuar përkeqësimin e gjendjes, meqë ZKA ka dhënë opinion të kualifikuar për 2017-tën, çka është një shkallë më mirë se opinionin i kundërt për vitin pasues.<sup>4</sup>

Bordi i tanishëm i Hidroregjionit Jugor është emëruar në tetor 2015 dhe ka vazhduar në detyrë përtej mandatit 3-vjeçar.<sup>5</sup> Drejtorët e tashëm kanë qenë në ndërmarrje kur janë përpiluar pasqyrat financiare si dhe kur është dhënë opinionin i kundërt. Rrjedhi-

1 Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009 (LNP), neni 19.3.

2 Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i auditimit të Kompanisë Rajonale të Ujësjetësit Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018, qershor 2019, f. 4.

3 Po aty, f. 9.

4 Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i auditimit: Pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjetësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, qershor 2018, f. 4.

5 Vendim i Qeverisë nr. 11/56, 30.10.2015.

misht, Qeveria ka arsye të besojë drejtorët kanë shkelur detyrat fiduciare, duke lejuar raportimin e rremë financiar, andaj duhet t'i shkarkojë ata.

Kur shkarkohet bordi, Qeveria duhet të emërojë sa më shpejt një bord të përkohshëm, që shërben deri në zgjedhjen e bordit me mandat të plotë, por jo më shumë se 6 muaj.<sup>6</sup> Kandidatët e paraqitur në këtë propozim-vendim janë ekspertë të qeverisjes korporative dhe të fushave në të cilat operon ndërmarrja.

Bordi i përkohshëm i drejtorëve do të ketë këtë përbërje:

- z. Ylber Elshani, auditor (kryesues);
- znj. Arieta Vula-Pozhegu, ekonomiste;
- z. Altin Sahiti, auditor; dhe
- z. Edmond Halimi, hidroinxhinier.

Rrjedhimisht, i propozoj Qeverisë të nxjerrë vendim për shkarkimin e bordit të tanishëm dhe emërimin e një bordi të përkohshëm.

**Rozeta HAJDARI**

---

Ministre në detyrë

---

<sup>6</sup> LNP, neni 43.